



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 139

Tiranë – E premte, 21 tetor 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshilit të Ministrave nr. 665, datë 19.10.2022	Për disa ndryshime në vendimin nr. 639, datë 6.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë” 17413
Vendim i Këshilit të Ministrave nr. 666, datë 19.10.2022	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rikualifikimi urban i lagjes ‘28 Nëntori’ i qytetit të Ballshit, Mallakastër” 17413
Vendim i Këshilit të Ministrave nr. 667, datë 19.10.2022	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Lidhja e autostradës Milot–Morinë me Aeroportin e Kukësit” 17417
Vendim i Këshilit të Ministrave nr. 668, datë 19.10.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 794, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Tiranë–Elbasan’ (shtesa)” 17420
Vendim i Këshilit të Ministrave nr. 670, datë 19.10.2022	Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar 17421
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 20, datë 14.10.2022	Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore për shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, për vitin buxhetor 2022 17426
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 419, datë 21.9.2022	Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Ankandit Shirokë 17428

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 459, datë 12.10.2022	Për shpalljen e zonës së shënuar dhe masat për kufizimin e përhapjes së dëmtuesit për virusin e rrudhosjes kafe të frutës së domates (ToBRFV).....	17433
Urdhër i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 621, datë 17.10.2022	Për delegimin e kompetencave.....	17433
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Arjan Bulku.....	17434

**VENDIM**

Nr. 665, datë 19.10.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 639, DATË 6.11.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË AGJENCISË SË AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË ASISTENCËS, AKREDITUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 21, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të pikës 4, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 639, datë 6.11.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 3, shifra “21” zëvendësohet me “23”.

b) Në ndarjen IV, të skemës 2, “Organika e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Evropian”, numri i audituesve të parë ndryshohet nga “2” në “4” dhe numri i përgjithshëm i punonjësve të kësaj ndarjeje ndryshohet nga “5” në “7”.

2. Ngarkohet Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Evropian për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Belinda Balluku****VENDIM**

Nr. 666, datë 19.10.2022

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “RIKUALIFIKIMI URBAN I LAGJES ‘28 NËNTORI’ I QYTETIT TË BALLSHIT, MALLAKASTËR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rikualifikimi urban i lagjes ‘28 Nëntori’ i qytetit të Ballshit, Mallakastër”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Mallakastër.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit “truell”, “ndërtesë banimi” dhe “njësi shërbimi”, me një vlerë të përgjithshme prej 7 164 536.75 (shtatë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 7 164 536.75 (shtatë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e pesë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Mallakastër.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Mallakastër.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për



efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Mallakastër.

8. Bashkia Mallakastër kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Mallakastër.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Mallakastër.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Mallakastër, pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe të regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Bashkisë Mallakastër.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Bashkia Mallakastër, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Mallakastër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI “RIKUALIFIKIMI URBAN I LAGJES ‘28 NËNTORI’ TË QYTETIT TË BALLSHIT, BASHKIA MALLAKASTËR”

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT HIPOTEKARE								VLERËSIMET PËR SHPRONËSIMET							SHËNIME
												TRUALL			NDËRTESE				
	Emri	Atësi	Mbiemri	Qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja totale	Truall m²	Ndërtesë m²	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	VLERA TOTALE (lek)	
1	Albert	Shyqyri	Meçanaj	Ballsh	1090	4/113	174	174	0	7	192	174	1406	244,644.00	0	0	0	244,644.00	
2	Albert	Shyqyri	Meçanaj	Ballsh	1090	4/328	1376	1376	0	22	207	1376	1406	1,934,656.00	0	0	0	1,934,656.00	
3	Adrian	Sabri	Hazizaj	Ballsh	1090	4/338	33	33	33	23	15	16	1406	22,496	16	21144.9	338,318.00	360,814.00	Në këtë pasuri prej 33 m² preken nga projekti vetëm 16 m², sipërfaqe, për të cilën është bërë dhe llogaritja e vlerës së shpronësimit. Llogaritja e vlerës së shpronësimit është bërë sipas situacionit bashkëlidhur dosjes. Çmimi prej 21144.9 lekësg/m² për ndërtesën është çmimi i cili del si rezultat i pjesëtimit të vlerës totale të objektit me sipërfaqen e tij, pasi ky objekt është objekt njësi shërbimi dhe llogaritja e vlerës së shpronësimit është bërë me situacion punimesh.
4	Luan	Muhamet	Nuhaj	Ballsh	1090	4/183	87	87	24.75	9	237	87	1406	122,322.00	24.75	21,193	524,526.75	646,848.75	Vlera prej 21193 lekësh/m² është marrë sipas çmimit mesatar të shitblerjeve të kryera nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Mallakastër, konfirmuar me shkresën nr. 25/1 prot., datë 14.2.2022, të cilën e gjeni bashkëlidhur dokumenteve.
5	Isuf	Haxhi	Hodaj	Ballsh	1090	4/343	320	320	0	23	45	320	1406	449,920.00	0	0	0	449,920.00	
6	Donika Gjinovefa Ismail Leonora Merjeme Njoftime Shqiponjë Veleđin	Meçan Meçan Meçan Meçan Meçan Meçan	Sopiku Myrtaj Meçanaj Çobo Alimi Sinaj Ymeraj Meçanaj	Ballsh	1090	4/342	951	951	0	23	44	951	1406	1,337,106.00	0	0	0	1,337,106.00	Gjeneralitet e bashkëpronarëve dhe të dhënat e tjera në lidhje me pronën të paraqitura në këtë tabelë janë sipas të dhënave të kartelave të pasurive të paluajtshme, si dhe sipas dokumenteve të identifikimit të tyre.
7	Donika Gjinovefa Ismail Leonora Merjeme Njoftime Shqiponjë Veleđin	Meçan Meçan Meçan Meçan Meçan Meçan	Sopiku Myrtaj Meçanaj Çobo Alimi Sinaj Ymeraj Meçanaj	Ballsh	1090	4/168	1125	1125	0	7	191	1125	1406	1,581,750.00	0	0	0	1,581,750.00	Gjeneralitet e bashkëpronarëve dhe të dhënat e tjera në lidhje me pronën të paraqitura në këtë tabelë janë sipas të dhënave të kartelave të pasurive të paluajtshme, si dhe sipas dokumenteve të identifikimit të tyre.
8	Donika	Meçan	Sopiku	Ballsh	1090	4/116	433	433	0	7	196	433	1406	608,798.00	0	0	0	608,798.00	Gjeneralitet e bashkëpronarëve



Gjinovefa	Meçan	Myrtaj																dhe të dhënat e tjera në lidhje me pronën të paraqitura në këtë tabelë janë sipas të dhënave të kartelave të pasurive të paluajtshme, si dhe sipas dokumenteve të identifikimit të tyre.
Ismail	Meçan	Meçanaj																
Leonora	Meçan	Çobo																
Merjeme	Meçan	Alimi																
Njoftime	Meçan	Sinaj																
Shqiponjë	Meçan	Ymeraj																
Veledin	Meçan	Meçanaj																
SHUMA																	7,164,536.75	

**VENDIM****Nr. 667, datë 19.10.2022**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I SEGMENTIT RRUGOR “LIDHJA E
AUTOSTRADËS MILOT–MORINË ME
AEROPORTIN E KUKËSIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Lidhja e autostradës Milot–Morinë me Aeroportin e Kukësit”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 650 118 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e njëqind e tetëmbëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, në masën 650 118 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e njëqind e tetëmbëdhjetë) lekë, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive, pronë private, të pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimit, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar për pasuritë e shpronësuara.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Kukës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**



LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
“LIDHJA E AUTOSTRADËS MILOT–MORINË ME AEROPORTIN E KUKËSIT”

NR.	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	ZONA KADASTRALE.	NUMRI I PASURISË	SIP. TOTALE (M²)	TOKË ARË			TOKË TRUALL			SIP. NDËRTIMI (M2)	VLERA (lek)	SHËNIME
							SIP. (M²)	ÇMIMI (LEK/M²)	VLERA (LEKË)	SIP. (M²)	ÇMIMI (LEK/M²)	VLERA (LEKË)			
FSHATI GOSTIL ZK. 1819															
1	INDRIT BEKIM	RAMAZAN RAMAZAN	REXHA REXHA	1819	2/8	1500			0	696	203	141288		141288	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	BEKIM INDRIT	RAMAZAN RAMAZAN	REXHA REXHA	1819	2/15	2500			0	654	203	132762		132762	Konfirmuar nga ASHK-ja
3	QAMIL	DIN	MURATI	1819	61/267	4140	283	132	37356					37356	Konfirmuar nga ASHK-ja
4	MALIQ	KURTISH	MURATI	1819	61/266	2541	215	132	28380					28380	Konfirmuar nga ASHK-ja
5	DAUT	HALIL	MURATI	1819	61/265	2090	176	132	23232					23232	Konfirmuar nga ASHK-ja
6	XHEM	ASLLAN	MURATAJ	1819	61/264	9408	403	132	53196					53196	Konfirmuar nga ASHK-ja
FSHATI SHTIQEN ZK. 3425															
7	LULZIM	REXHEP	LEKICA	3425	695/22/1	1933	36	132	4752					4752	Konfirmuar nga ASHK-ja
8	LULZIM	REXHEP	LEKICA	3425	695/24/1	995	29	132	3828					3828	Konfirmuar nga ASHK-ja
9	SADIK	SUL	LEKICA	3425	695/30/1	165	38	132	5016					5016	Konfirmuar nga ASHK-ja
10	KAMBER	SUL	LEKICA	3425	695/26/1	1646	37	132	4884					4884	Konfirmuar nga ASHK-ja
11	RAM	SALI	LEKICA	3425	695/33/1	2647	277	132	36564					36564	Kufizim ne seksionin D,Ndalohen veprimet deri ne konfirm e AMTP; Urdhër I drejtorit për kufizim
12	ISLAM	SALI	LAMI	3425	701/1/1	1685	202	132	26664					26664	Konfirmuar nga ASHK-ja
13	BAJRAM	DALI	LAMI	3425	701/5/1	360	51	132	6732					6732	Kufizim ne seksionin D,Ndalohen veprimet deri ne konfirm e AMTP
14	ASHIK BAJRAM FAHRIJE SHEHU (AXHAMI) DALI LUMTURIJE Tafa (AXHAMI) DALI LUTFI SADIJE ADEMI (AXHAMI) DALI	DALI DALI DALI	AXHAMI AXHAMI AXHAMI	3425	701/6/1	503	65	132	8580					8580	Konfirmuar nga ASHK-ja
15	HYSNI	HAJRULLAH	CENGU	3425	701/7/1	672	93	132	12276					12276	Kufizim ne seksionin D, Urdhër I drejtorit për kufizim
16	RIZA	HAJRULLAH	CENGU	3425	701/8/1	660	79	132	10428					10428	Konfirmuar nga ASHK-ja
17	QEMAL	QAZIM	BASHA	3425	701/10/1	591	53	132	6996					6996	Konfirmuar nga ASHK-ja
18	ZOJE	ISMAIL	BASHA	3425	701/11/1	708	72	132	9504					9504	Konfirmuar nga ASHK-ja
19	BAJRAM	DIN	CENGU	3425	688/28/1	1216	102	132	13464					13464	Kufizim ne seksionin D,Ndalohen veprimet deri ne konfirm e AMTP; Urdhër i drejtorit për kufizim
20	OSMAN	ZENEL	CENGU	3425	688/14/1	370	19	132	2508					2508	Konfirmuar nga ASHK-ja
21	FATIME	JASHAR	CENGU	3425	688/15/1	412	12	132	1584					1584	Kufizim ne seksionin D,Ndalohen veprimet deri ne konfirm e AMTP
22	DYLEJMAN	ZENEL	CENGU	3425	688/16/1	403	5	132	660					660	Kufizim ne seksionin D,Ndalohen veprimet deri ne konfirm e AMTP



23	RIZA	HAJRULLAH	CENGU	3425	688/17/1	602	46	132	6072				6072	Konfirmuar nga ASHK-ja
24	FATMIR	HYSNI	CENGU	3425	688/18/1	232	72	132	9504				9504	Kufizim ne seksionin D,Ndalohe veprimet deri ne konfirm e AMTP
25	HAMDI	HYSNI	CENGU	3425	688/19/1	222	86	132	11352				11352	Kufizim ne seksionin D,Ndalohe veprimet deri ne konfirm e AMTP
26	SHKËLZEN	RAKIP	ISEBERI	3425	688/20/10	245	105	132	13860				13860	Konfirmuar nga ASHK-ja (Plotësim dokumentacioni)
27	XHEMALI	IBRAHIM	AXHAMI	3425	688/20/13	141	63	132	8316				8316	Konfirmuar nga ASHK-ja
28	HAMDI	OSMAN	CENGU	3425	688/20/16	410	167	132	22044				22044	Kufizim ne seksionin D,Ndalohe veprimet deri ne konfirm e AMTP
29	HALIL	DEM	MUCMATA	3425	688/25/3	197	63	132	8316				8316	Kufizim ne seksionin D,Ndalohe veprimet deri ne konfirm e AMTP
		SHUMA					2,849.00		376,068.00	1,350		274,050.00	650,118.00	

SHËNIM. ÇMIMET PËR LLOJIN E PASURISË JANË MARRË BAZUAR NË VKM NR. 89, DATË 3.2.2016, “PËR MIRATIMIN E HARTËS SË VLERËS SË TOKËS NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

**VENDIM****Nr. 668, datë 19.10.2022**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 794, DATË 22.9.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR ‘TIRANË–
ELBASAN’ (SHTESA)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 794, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 3 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “arë”, “ullishte” dhe “drufrutorë”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 12 039 835 (dymbëdhjetë milionë e tridhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë) lekësh, nga të cilat:

a) tokë “arë”, me sipërfaqe 42 966 (dyzet e dy mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) m², me vlerë 10 307 835 (dhjetë milionë e treqind e shtatë mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë) lekë;

b) “ullishte”, me sipërfaqe 300 (treqind) m², me vlerë 70 800 (shtatëdhjetë mijë e tetëqind) lekë;

c) “drufrutorë”, me vlerë 1 661 200 (një milion

e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e dyqind) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 12 039 835 (dymbëdhjetë milionë e tridhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë) lekësh, përballohet, si më poshtë vijon:

a) 11 600 385 (njëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind mijë e treqind e tetëdhjetë e pesë) lekë përballohen nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri “Shpronësime”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

b) 439 450 (katërqind e tridhjetë e nëntë mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.”

2. Në tabelën e të shpronësuarve, bashkëlidhur vendimit nr. 794, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

4. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, për pasurinë nr. 127, zona kadastrale 1997, pasqyron në kartelën e pasurisë së paluajtshme informacionin për miratimin e shpronësimit për interes publik të pasurisë, pronë private, dhe për sipërfaqen që mbetet “tokë bujqësore”.

II. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrotjtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku



LISTA EMËRORE E PRONARIT, PASURIA PRONË PRIVATE E TË CILIT PREKET NGA DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 794, DATË 22.9.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘TIRANË–ELBASAN’ (SHTESA)”

NR. RENDOR	TË DHËNAT PËR PRONARIN					VLERËSIMET		VLERA		SHËNIME
	EMRI I PRONARIT	ZK	NR. I PAS.	LLOJI I PASURISË	SIP. TOTALE	SIP. SHTESË PËR SHPRONËS. (m ²)	ÇMIMI (LEK/m ²)	VLERA (LEK)	TOTALE (LEK)	
1	Hysni Halit Sherifi	1997	127	Arë	2,600	935	470	439,450	439,450	Konfirmim ASHK (shpronësuar me VKM-në nr. 794, datë 22.9.2015, për sipërfaqen 1365 m ² . Referuar VKT-së nr. 57, datë 26.10.2017 dhe nr. 64/1, datë 7.6.2017, kërkohet për shpronësim sipërfaqja shtesë prej 935 m ²)
Vlera totale						935		439,450	439,450	

Vlerësimi për pasurinë e llojit “arë” është bërë në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

VENDIM**Nr. 670, datë 19.10.2022**

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN, PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE, TË NDRYSHUARA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

a) Në pikën 7, të kreut I, pas fjalëve “... (CFSP) 2022/1355 ...” shtohen “... (CFSP) 2022/1447 ...”;

b) Në aneksin 7, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2022/1447, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Belinda Balluku**



VENDIME

VENDIM I KESHILLIT (CFSP) 2022/1447

i datës 1 shtator 2022

për ndryshimin e Vendimit 2014/145/CFSP në lidhje me masat kufizuese në lidhje me veprimet
minuar ose kërcënuar integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës

KESHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nën 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë,

Ndërsa:

- (1) Më 17 mars 2014, Këshilli miratoi Vendimin 2014/145/CFSP (1).
- (2) Bashkimi mbetet i palëkundur në mbështetjen e tij për sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës dhe vazhdon të dënojë veprimet dhe politikat që cenojnë integritetin territorial të Ukrainës.
- (3) Duke pasur parasysh peshën e situatës, Këshilli konsideron se tre persona përgjegjës për veprime që cenojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës duhet t'i shtohen listës së personave, subjekteve dhe organeve që i nënshtrohen masave kufizuese të përcaktuara në Aneksin e Vendimit 2014/145/CFSP.
- (4) Vendimi 2014/145/CFSP prandaj duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KETË VENDIM:

Neni 1

Aneksi i Vendimit 2014/145/CFSP është ndryshuar në përputhje me Aneksin e këtij Vendimi.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Bruksel, 1 shtator 2022.

*Për Këshillin**Presidenti*

M. BEK

(1) Vendimi i Këshillit 2014/145/CFSP i 17 marsit 2014 në lidhje me masat kufizuese në lidhje me veprimet që cenojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës (OJL 78, 17.3.2014, f. 16).



1.9.2022

[EN]

Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian

L 227 II/5

AMEKS

Personat e mëposhtëm i shihen listës së personave, subjekteve dhe organeve të përcaktuara në Aneksin e Vendimit 2014/145/CFSP:

Personat



	Emri	Informacion identifikues	Arsyet	Data e listimit
1230.	Alla Viktorovna POLYAKOVA (Anna BuKTopoBHa non "KOBA")	Datëlindja: 26.11.1970 Vendlindja: Ryazan, Federata Ruse Kombësia: Ruse Gjinia: femër	Anëtar i Dumës së Shtetit, i cili votoi në favor të rezolutës nr. 58243-8 "Për apelin e Dumës Shtetërore të Asamblesë Federale të Federatës Ruse drejtuar Presidentit të Federatës Ruse V.V. Putin mbi nevojën për të njohur Republikën Popullore të Donetskut dhe Republikën Popullore të Luhanskut dhe për këtë arsye mbështeti dhe zbatoi veprimet dhe politika që minojnë integritetin territorial, sovrانيتin dhe pavarësinë e Ukrainës dhe destabilizuan më tej Ukrainën.	1.9.2022
1231.	Anton Olegovich TKACHEV (Антон Олегович ТКАЧЕВ)	Datëlindja: 31.3.1994 Vendlindja: Voronezh, Federata Ruse Kombësia: Ruse Gjinia: mashkull	Anëtar i Dumës së Shtetit, i cili votoi në favor të rezolutës nr. 58243-8 "Për apelin e Dumës Shtetërore të Asamblesë Federale të Federatës Ruse drejtuar Presidentit të Federatës Ruse V.V. Putin mbi nevojën për të njohur Republikën Popullore të Donetskut dhe Republikën Popullore të Luhanskut dhe për këtë arsye mbështeti dhe zbatoi veprimet dhe politika që minojnë integritetin territorial, sovrانيتin dhe pavarësinë e Ukrainës dhe destabilizuan më tej Ukrainën.	1.9.2022
1232.	Valery Andreevich PONOMAREV (Валерий Андреевич ПОНОМАРЕВ)	Datëlindja: 17.8.1959 Vendlindja: Rrethi Kurilsky, Rajoni Sakhalin, Federata Ruse Kombësia: Ruse Gjinia: mashkull	Anëtar i Këshillit të Federatës i cili ratifikoi vendimet e qeverisë të "Traktatit të miqësisë, bashkëpunimit dhe ndihmës së ndërsjellë midis Federatës Ruse dhe Republikës Popullore të Donetskut dhe midis Federatës Ruse dhe Republikës Popullore të Luhanskut".	1.9.2022



DECISIONS

COUNCIL DECISION (CFSP) 2022/1447

of 1 September 2022

amending Decision 2014/145/CFSP concerning restrictive measures in respect of actions undermining or threatening the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 17 March 2014, the Council adopted Decision 2014/145/CFSP ⁽¹⁾.
- (2) The Union remains unwavering in its support for Ukraine's sovereignty and territorial integrity and continues to condemn actions and policies undermining the territorial integrity of Ukraine.
- (3) In view of the gravity of the situation, the Council considers that three persons responsible for actions undermining or threatening the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine should be added to the list of persons, entities and bodies subject to restrictive measures set out in the Annex to Decision 2014/145/CFSP.
- (4) Decision 2014/145/CFSP should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

The Annex to Decision 2014/145/CFSP is amended in accordance with the Annex to this Decision.

*Article 2*This Decision shall enter into force on the date of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 1 September 2022.

For the Council
The President
M. BEK

⁽¹⁾ Council Decision 2014/145/CFSP of 17 March 2014 concerning restrictive measures in respect of actions undermining or threatening the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine (OJ L 78, 17.3.2014, p. 16).



1.9.2022

EN

Official Journal of the European Union

L 227 1/5

ANNEX

The following persons are added to the list of persons, entities and bodies set out in the Annex to Decision 2014/145/CFSP:

Persons

	Name	Identifying information	Reasons	Date of listing
1230.	Alla Viktorovna POLYAKOVA (Алла Викторовна ПОЛЯКОВА)	DOB: 26.11.1970 POB: Ryazan, Russian Federation Nationality: Russian Gender: female	Member of the State Duma who voted in favour of the resolution No 58243-8 'On the appeal of the State Duma of the Federal Assembly of the Russian Federation To the President of the Russian Federation V.V. Putin on the need to recognize the Donetsk People's Republic and the Luhansk People's Republic' and therefore supported and implemented actions and policies which undermine the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine, and further destabilised Ukraine.	1.9.2022
1231.	Anton Olegovich TKACHEV (Антон Олегович ТКАЧЕВ)	DOB: 31.3.1994 POB: Voronezh, Russian Federation Nationality: Russian Gender: male	Member of the State Duma who voted in favour of the resolution No 58243-8 'On the appeal of the State Duma of the Federal Assembly of the Russian Federation To the President of the Russian Federation V.V. Putin on the need to recognize the Donetsk People's Republic and the Luhansk People's Republic' and therefore supported and implemented actions and policies which undermine the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine, and further destabilised Ukraine.	1.9.2022
1232.	Valery Andreevich PONOMAREV (Валерий Андреевич ПОНОМАРЕВ)	DOB: 17.8.1959 POB: Kurilsky District, Sakhalin Region, Russian Federation Nationality: Russian Gender: male	Member of the Federation Council who ratified the government decisions of the 'Treaty of Friendship, Cooperation and Mutual Assistance between the Russian Federation and the Donetsk People's Republic and between the Russian Federation and the Luhansk People's Republic'.	1.9.2022



UDHËZIM

Nr. 20, datë 14.10.2022

Lidhja 1

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË
PËR KRITERET DHE PROCEDURAT
PËR SHPËRNDARJEN DHE
PËRDORIMIN E SUBVENCIONEVE
SHTETËRORE PËR SHOQËRITË
AKSIONARE TË UJËSJELLËS-
KANALIZIMEVE, PËR VITIN
BUXHETOR 2022**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 13, shkronja “dh”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11.7.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.5.2022, “Politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”,

UDHËZOJ:

1. Zbatimin e metodologjisë “Për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, për vitin buxhetor 2022”, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, të gjitha shoqëritë e ujësjellës-kanalizime.

3. Udhëzimi nr. 3, datë 18.6.2020, “Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore për shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, për vitin buxhetor 2020 dhe 2021”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku**

METODOLOGJI

**PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR
SHPËRNDARJEN DHE PËRDORIMIN E
SUBVENCIONEVE SHTETËRORE
SHOQËRITË AKSIONARE TË
UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE PËR VITIN
BUXHETOR 2022**

Kjo metodologji është hartuar në mbështetje të pikës 13, shkronja “dh”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11.7.2018, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.5.2022, “Politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, dhe në përputhje me ligjin nr. 115, datë 25.11.2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, dhe udhëzimin nr. 2, datë 6.2.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”.

Detajimi i fondit të subvencionit për çdo Shoqëri Rajonale të Ujësjellës-Kanalizimeve sh.a. (në vijim “Shoqëri Rajonale”), dhe përdorimi i tij do të bëhet, si më poshtë:

1. Subvencioni do të shpërndahet nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (në vijim “AKUM”) në masën e planifikuar në ligjin vjetor të buxhetit, në përputhje me zërin buxhetor subvencione, me llogari ekonomike (603) dhe të gjithë shtesave të tjera të bëra me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Subvencioni i përfutur, sipas pikës 1 të kësaj metodologjie, do të përdoret nga AKUM-ja, për t’u ofruar ndihmë Shoqërive Rajonale, që janë krijuar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” (VKM nr. 302/2022), dhe shoqërive që janë në procesin e krijimit të Shoqërisë Rajonale, nëse këto kanë nënshkruar marrëveshjen për krijimin e Shoqërisë së re Rajonale.

3. Prioritet për përdorimin e fondit nga Shoqëritë Rajonale ose/dhe shoqëritë të cilat kanë nënshkruar Marrëveshjen për krijimin e Shoqërisë Rajonale është likuidimi i detyrimeve emergjente, të cilat pengojnë veprimtarinë normale të shoqërisë,



sipas pikës 4 të kësaj metodologjie. Në rast se fondi i subvencionit pas kryerjes së likuidimeve të detyrimeve të mësipërme do të teprojë, atëherë Shoqëria Rajonale mund të përdorë pjesën e mbetur për përmirësimin e performancës së shoqërisë, sipas pikës 5, pas miratimit nga Asambleja e Përgjithshme për ndryshimin e radhës së përdorimit të subvencionimit.

4. Shoqëritë Rajonale ose/dhe shoqëritë të cilat kanë nënshkruar Marrëveshjen për krijimin e Shoqërisë Rajonale përdorin subvencionin për likuidimin e detyrimeve emergjente, të cilat pengojnë veprimtarinë normale të shoqërisë, siç janë:

a) pagesat e prapambetura të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të shoqërive ujësjellës-kanalizime të përthithura, të cilat janë transferuar te Shoqëria Rajonale;

b) pagesat e detyrimeve ndaj degës së Tatim-Taksave;

c) pagesat e prapambetura të pagave;

d) Pagesat e prapambetura ndaj OSHEE-së, të shoqërive ujësjellës-kanalizime të përthithura, të cilat janë transferuar te Shoqëria Rajonale.

5. Shoqëritë Rajonale ose/dhe shoqëritë të cilat kanë nënshkruar Marrëveshjen për krijimin e Shoqërisë Rajonale përdorin subvencionin për përmirësimin e performancës, për:

a) përmirësimin e sistemit të matjes (blerje matësish);

b) blerje të mjeteve të punës, materialeve hidraulike, makinerive dhe pajisjeve;

c) blerje të pajisjeve informatike dhe sistemeve;

d) ndërhyrje në rrjet për të zvogëluar humbjet (UPA);

e) ngritja e qendrave të kujdesit të klientit në qytetet në të cilat nuk ka të tilla;

f) rikonstruktion zyrash.

6. Fondi i subvencionit, i planifikuar për vitin buxhetor 2022, do të shpërndahet në mënyrë të barabartë për të gjitha Shoqëritë Rajonale që janë të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) deri në datën 31.10.2022 dhe shoqërive që janë në procesin e krijimit të Shoqërisë Rajonale, nëse këto kanë nënshkruar marrëveshjen për krijimin e Shoqërisë të re Rajonale.

7. Vlerësimi i nevojave për subvencione, si dhe detajimi dhe shpërndarja e subvencionit nga AKUM-ja, do të bazohet në të dhënat e raportuara nga Shoqëritë Rajonale ose/dhe shoqëritë të cilat

kanë nënshkruar Marrëveshjen për krijimin e Shoqërisë Rajonale, pranë AKUM-së, në përputhje me kërkesat, formatin dhe afatet e përcaktuara.

8. Kërkesa për subvencionim nga Shoqëritë Rajonale ose/dhe shoqëritë të cilat kanë nënshkruar Marrëveshjen për krijimin e Shoqërisë Rajonale duhet të përmbajë në mënyrë të argumentuar problematikat që kanë, problematikat të cilat janë prioritet për t'u zgjidhur dhe planin e shpenzimeve për fondin e subvencionimit që kërkojnë.

9. AKUM-ja vlerëson dokumentacionin/të dhënat e paraqitur/a dhe bën shpërndarjen e subvencionit, sipas kërkesave të Shoqërive Rajonale ose/dhe shoqëritë të cilat kanë nënshkruar marrëveshjen për krijimin e Shoqërisë Rajonale.

10. AKUM-ja përgatit listën e të gjithë Shoqërive Rajonale të cilat janë regjistruar në QKB, sipas VKM-së nr. 302/2022 deri në datën 31 tetor 2022 dhe shoqërive që janë në procesin e krijimit të Shoqërisë Rajonale, nëse këto kanë nënshkruar marrëveshjen për krijimin e Shoqërisë të re Rajonale.

11. AKUM-ja llogarit vlerën e subvencionit që do të përfitojë secila Shoqëri Rajonale ose/dhe Shoqëritë të cilat kanë nënshkruar Marrëveshjen për krijimin e Shoqërisë Rajonale, si dhe njofton Shoqëritë.

12. Administratori i Shoqërisë Rajonale duhet të paraqesë propozimin për mënyrën e përdorimit të subvencionit me relacion shpjegues justifikues për secilin zë të propozuar, si dhe me një analizë mbi përparësinë e zërave të propozuar, në krahasim me nevojat e tjera të Shoqërisë Rajonale dhe të marrë miratimin në Këshillin Mbikëqyrës dhe në Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë.

13. Administratori i Shoqërisë, që ka nënshkruar marrëveshjen për krijimin e Shoqërisë së re Rajonale dhe është në procesin e krijimit të saj, duhet të paraqesë propozimin për mënyrën e përdorimit të subvencionit me relacion shpjegues justifikues për secilin zë të propozuar, si dhe me një analizë mbi përparësinë e zërave të propozuar, në krahasim me nevojat e tjera të Shoqërisë në Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë.

14. Pas miratimit në Asamblenë e Përgjithshme, shoqëria mund të përdorë fondet e subvencionit bazuar në dokumentacionin justifikues të shpenzimeve.



15. AKUM-ja, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11.7.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”, neni 13, shkronja “ë”, ka të drejtë të ushtrojë kontrolle, për të vlerësuar mënyrën e përdorimit të fondit të akorduar për çdo shoqëri, që ka përfituar nga fondi i subvencionimit.

16. Në mënyrë periodike, çdo tre muaj, AKUM-ja informon MIE-n për performancën e Shoqërive Rajonale ose/dhe shoqëritë të cilat kanë nënshkruar Marrëveshjen për krijimin e Shoqërisë Rajonale.

17. Disbursimi i vlerës së subvencionit, pavarësisht nëse përdoret për pagesën e detyrimeve korrente ose të prapambetura për tatime, sigurime ose me qëllim rritjen e performancës dhe investime kapitale, llogaritet dhe regjistrohet nga shoqëritë si kontribut i vlerës së kapitalit aksionar të MIE-s në Shoqërinë Rajonale ose/dhe shoqëritë të cilat kanë nënshkruar marrëveshjen për krijimin e Shoqërisë Rajonale.

URDHËR

Nr. 419, datë 21.9.2022

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS SË ANKANDIT SHIROKË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të shkronjës “g”, të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural miraton rregulloren, si më poshtë.

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Ankandit Shirokë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Inspektorati i Peshkimit pranë Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të Liqenit të Shkodrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL**
Frida Krifca

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS SË ANKANDIT SHIROKË

Neni 1 Objekti

Kjo Rregullore përcakton mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Qendrës së Ankandit Shirokë, për shitjen me shumicë, pakicë dhe tregtimin e produkteve peshkore të liqenit të Shkodrës.

Neni 2 Qëllimi

1. Qendra e Ankandit Shirokë është strukturë me interes publik, e cila ka për qëllim:

- a) promovimin e marketingut të produkteve të peshkimit, me qëllim sigurimin e shpejtësisë dhe të efikasitetit të përgjithshëm të shpërndarjes së tyre;
- b) zhvillimin e profesionalizmit sipërmarrës me aktivitet tregtar, peshkimin;
- c) mbrojtjen e komponentëve më të dobët të prodhimit dhe të tregtisë, duke lidhur konsumin me prodhimin dhe duke garantuar zinxhirin e tregtimit për të ulur koston e përgjithshme.

Neni 3 Menaxhimi i Qendrës së Ankandit

1. Qendra e Ankandit Shirokë administrohet nga Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës (në vijim “OMP-ja e liqenit të Shkodrës”) në përputhje me urdhrin nr. 43, datë 5.2.2018, të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

2. Në këtë Qendër Ankandi ushtrojnë veprimtaritë e tyre dhe organet shtetërore, si: Inspektorati i Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, struktura të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe organe të tjera që kanë lidhje me funksionimin normal të këtij tregu.



Neni 4

Komiteti Këshillimor i Qendrës

1. Për menaxhimin e Qendrës së Ankandit Shirokë krijohet Komiteti Këshillimor i Qendrës, me mandat trevjeçar. Anëtarët e Komitetit kanë të drejtë të rizgjidhen.

2. Komiteti Këshillimor i Qendrës drejtohet nga kryetari i OMP-së së liqenit të Shkodrës ose nga një përfaqësues i autorizuar prej tij, i cili luan rolin e kryetarit.

3. Komiteti Këshillimor ka në përbërje:

- a) dy anëtarë nga OMP-ja e liqenit të Shkodrës;
- b) një përfaqësues të tregtarëve me shumicë;
- c) një përfaqësues të tregtarëve me pakicë;
- ç) inspektorin e peshkimit të qarkut;
- d) inspektorin e drejtorisë rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;

dh) një përfaqësues i të punësuarve tek Qendra e Ankandit;

e) një përfaqësues nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

4. Komiteti Këshillimor i tregut mbledhet nga kryetari sa herë që e sheh të nevojshme ose me kërkesë të bërë nga një e treta e anëtarëve.

5. Njoftimet e takimit me rendin e ditës dërgohen tek anëtarët të paktën shtatë ditë para datës së mbledhjes, pa paragjykuar asnjë kërkesë urgjente për të cilën dërgohet njoftim 24 orë nga çdo mjet i vlefshëm komunikimi.

6. Në mbledhjet e Komitetit Këshillimor mund të marrin pjesë, pa të drejtë vote, ekspertë për çështjet që do të shqyrtohen ose përfaqësues të grupeve të tjera të interesit.

7. Mbledhjet quhen të vlefshme kur në të marrin pjesë 50% + 1 të anëtarëve të tij.

8. Anëtarët e Komitetit, të cilët mungojnë për tri mbledhje radhazi, pa arsye, humbasin mandatin.

9. Vendimet merren me shumicë votash dhe, në rast barazimi, vota e kryetarit është përcaktuese.

10. Menaxhuesi i tregut vendos në mënyrë të pavarur mbi propozimet e Komitetit Këshillimor.

Neni 5

Funksionet dhe detyrat e Komitetit Këshillimor

1. Komiteti Këshillimor kryen detyrat e mëposhtme:

a) propozon ndryshime dhe përmirësime për pajisjet dhe shërbimet e Qendrës, në mënyrë që të sigurohet produktiviteti maksimal dhe përmirësimi i efikasitetit funksional përfshirë edhe sigurinë ushqimore;

b) shpreh mendimin e tij dhe përcakton:

- i. oraret e funksionimit të Qendrës së Ankandit;
- ii. kriteret për ndarjen e vendeve të blerjes;
- iii. tarifat për dhënien me qira të frigoriferëve;
- iv. tarifat e shërbimeve të Qendrës;

v. organizimin e personelit të nevojshëm për funksionimin e shërbimeve të Qendrës dhe për çdo ndryshim të këtij organizimi;

vi. çdo çështje tjetër lidhur me aktivitetet në treg.

2. Pjesëmarrja në Komitetin Këshillimor të Tregut është pa shpërblim.

Neni 6

Drejtori i Qendrës së Ankandit

1. Drejtori i Qendrës së Ankandit emërohet dhe shkarkohet nga kryetari i OMP-së së liqenit Shkodër, me propozim të Komitetit Këshillimor. Ai zgjidhet nga radhët e profesionistëve të fushave të peshkimit dhe akuakulturës, drejtësisë dhe ekonomisë, me eksperiencë pune të paktën 5 vjet në profesion.

2. Drejtori është përgjegjës për funksionimin e rregullt të Qendrës dhe shërbimeve, organizimi i të cilës do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ai drejton, mbikëqyr dhe cakton detyrat për secilin punonjës, cakton turnet dhe orët e punës.

3. Drejtori i tregut kryen detyrat e mëposhtme:

a) konstaton plotësimin e kushteve për pjesëmarrjen në procedurën e ankandit;

b) ushtron kontroll mbi tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve të peshkimit;

c) mbikëqyr kohën e hapjes dhe të mbylljes së Qendrës;

ç) siguron që operacionet e furnizimit të Qendrës të mos pengohen;

d) siguron që të gjitha transaksionet e blerjes dhe të shitjes janë kryer sipas ligjeve dhe rregulloreve;

dh) autorizon, në raste të jashtëzakonshme, futjen dhe daljen e produkteve ushqimore përtej kohës së caktuar;

e) propozon, me sugjerimin e operatorëve, nismat që synojnë favorizimin e furnizimit të



Qendrës me produkte, zgjerimin e sipërfaqes së nevojshme për shitje;

ë) verifikon faktin që mallrat dhe ambalazhet përputhen me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi;

f) verifikon, me kërkesë të palëve të interesuara ose kryesisht, cilësinë e produktit dhe dokumentacionin shoqërues;

g) është përgjegjës për përmbushjen e të gjitha detyrave të lëna nga inspektori i ngarkuar për inspektimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit në Qendër;

gj) siguron mospërdorimin e praktikave mashtruese lidhur me peshën e produktit apo të çdo praktike tjetër që mund të përdoret nga tregtarët;

h) rregullon inspektimet gjatë orarit të mbylljes së Qendrës dhe, veçanërisht, natën;

i) në raste urgjente, merr masat e nevojshme për të cilat raporton te menaxheri i Qendrës;

j) siguron pajisjet e duhura për të mundësuar ruajtjen e mallrave në treg;

k) miraton akte brenda përgjegjësi të tij, në funksion të mirorganizimit të Qendrës;

l) siguron që veprimtaria e tregtarëve të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ll) kujdeset për ushtrimin e kontrollit veterinar dhe higjieno-sanitar të produkteve të peshkimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

m) kujdeset për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindin gjatë zhvillimit të ankandit.

4. Brenda 30 ditëve nga lindja e mosmarrëveshjeve, sipas shkronjës “r”, të pikës 3, të këtij neni, palët e interesuara kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, pranë drejtorit të tregut. Drejtori, brenda 30 ditëve, shqyrton pretendimet e tyre dhe vendos mbi to.

Neni 7

Personeli tjetër i tregut

1. Drejtori i Qendrës së Ankandit Shirokë, për të siguruar mirëfunksionimin e kësaj Qendre Ankandit, të produkteve peshkore, ndihmohet edhe nga personeli i mëposhtëm:

- a) shërbimi i ruajtjes dhe i pastrimit të Qendrës;
- b) shërbimi i transportit;
- c) shërbim për pajisjen me certifikatë origjine të produktit;
- ç) shërbimi i furnizimit me akull;
- d) çdo shërbim tjetër ndihmës në qendër.

Neni 8

Marrja e të dhënave statistikore dhe çmimet

1. Në Qendrën e Ankandit grumbullohen të dhëna për sasi të dhe çmimet e shitjes së produkteve të kontraktuara, sipas kreut XII, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 256, datë 24.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për grumbullimin, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshillimin shkencor për Strategjinë Kombëtare të Peshkimit”.

2. Dokumenti bazë për grumbullimin e të dhënave është fleta e ankandit, e cila ndër të tjera, përmban informacionin e mëposhtëm:

- a) llojet, cilësinë dhe sasinë;
- b) origjinën;
- c) blerësin.

3. Produktet e përziera lejohen vetëm nëse produkti është në të vërtetë i ofruar në treg si i tillë, edhe pse mbetet detyrimi për specifikimin e llojeve.

4. Të dhënat personale u nënshtrohen rregullave, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, ndërsa të dhënat e tjera, si për çmimet ashtu edhe për llojet, cilësitë dhe sasi të, janë objekt publikimi.

5. OMP-ja e liqenit të Shkodrës dërgon çdo muaj pranë Ministrisë të dhënat e grumbulluara të muajit paraardhës.

Neni 9

Fleta e ankandit

1. Fleta e ankandit përgatitet nga drejtori i Qendrës dhe përmban informacionet, si në vijim:

- a) kodin e identifikimit të prodhuesit;
- b) NIPT-in;
- c) origjinën e mallit;
- ç) numrin e arkave dhe peshën neto;
- d) listën e secilës shitje (duke specifikuar llojin e specieve, cilësinë, peshën dhe çmimin).

2. Fleta e ankandit nuk zëvendëson faturën tatimore të shitjes.

3. Modeli i fletës së ankandit gjendet në shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje.

Neni 10

Tarifat

1. Tarifat e shërbimit përllëgariten dhe miratohen nga OMP-ja e liqenit të Shkodrës, duke marrë mendimin edhe të Komitetit Këshillimor.



2. Tarifat kanë për qëllim mbulimin e shërbimeve që ofrohen në treg dhe përbëhen nga:

- a) tarifa për përdorimin e mjediseve të përbashkëta, pajisjeve të tregut, pastrimit, akullit;
- b) tarifa për shërbimin e ankandit;
- c) tarifa për shërbimin veterinar;
- ç) tarifa për shërbimin e ngarkim-shkarkimit.

3. Tarifat e miratuara janë të shpallura nën kujdesin e drejtorit të Qendrës, në vende të përshtatshme dhe sidoqoftë në të gjitha pikat e shitjes.

4. Tarifat përlogariten mbi bazën e numrit të arkave ose të sasisë së peshkut të kaluar në treg dhe paguhet në momentin e daljes së mallit.

5. Tarifa e akullit paguhet veçmas.

Neni 11

Oraret dhe kalendari

1. Orari dhe kalendari hartohen nga drejtori i Qendrës, duke marrë dhe mendimin e Komitetit Këshillimor dhe shpallen në hyrje të tregut.

2. Drejtori i Qendrës mund, në raste të veçanta, të vonojë ose shpejtojë hapjen ose mbylljen e shitblerjeve.

Neni 12

Dhënia në përdorim e magazinave dhe e dhomave frigoriferike

1. Magazinat dhe dhomat frigoriferike, që janë pjesë e tregut të Qendrës së Ankandit mund t'u jepen me qira operatorëve që bëjnë kërkesë nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë me OMP-në e liqenit të Shkodrës, sipas legjislacionit në fuqi, duke marrë mendimin edhe të Komitetit Këshillimor.

2. Për dhënien e magazinave dhe dhomave frigoriferike duhet të jenë të fiksuara nga ana e OMP-së së liqenit të Shkodrës, aktiviteti minimal vjetor. Mosarritja e këtyre niveleve minimale mund të çojë në heqjen e së drejtës së përdorimit të këtyre ambienteve ose transferimin në magazina ose dhoma frigoriferike me dimensione më të vogla në momentin e skadimit të kontratës.

3. Niveli minimal mund të ulet ose mund të quhet i pavlefshëm, kur kemi të bëjmë me forca madhore të paparashikuara dhe që kanë penguar ose reduktuar në mënyrë objektive aktivitetin e operatorit.

4. Tarifat e qirasë dhe të shërbimeve janë tarifatat që përcaktohen në VKM-në nr. 54, datë 5.2.2014, "Për përcaktimin e kriterëve dhe mënyrave të dhënies me qira ose enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar.

Neni 13

Kushtet higjieno-sanitare

1. Në Qendrën e Ankandit të Shirokës zbatohet plani i autokontrollit të bazuar mbi HACCP-në (*Hazard Analysis and Critical Control Points*), me qëllim që të garantojë sigurinë ushqimore të produkteve të peshkimit.

2. Qendra e Ankandit Shirokë siguron zbatimin e rregullave dhe të standardeve të sigurisë ushqimore.

Neni 14

Malli në shitje dhe tërheqja e prodhimit

1. Shitësi është i detyruar të sistemojë prodhimet peshkore, sipas dispozitave të lëshuara nga drejtoria e Qendrës dhe nga veterineri i Qendrës.

2. Shitësve u njihet e drejta të tërheqin nga tregu prodhimet e sjella pa i paguar kësaj të fundit asnjë lloj detyrimi të çfarëdolloj natyre.

3. Tërheqja e prodhimit nga tregu mund të ndalohet nga veterineri për arsye të karakterit higjieno-sanitar.

Neni 15

Qarkullimi i automjeteve

1. Qarkullimi dhe qëndrimi i automjeteve për ngarkimin dhe shkarkimin e prodhimeve të peshkut rregullohen nga drejtori i Qendrës me një urdhër të brendshëm.

2. Përdorimi i mjeteve të transportit të mallrave brenda Qendrës për veprimet e lëvizjes së mallit autorizohet nga drejtori i Qendrës.

Neni 16

Rregulla të brendshme

1. Në Qendrën e Ankandit dhe në zonat pranë saj ndalohet:

a) bllokimi i vendkalimeve me mbeturina ose sende të tjera ose sidoqoftë pengimi i qarkullimit;

b) asistimi në proceset e përpunimit ose të trajtimeve të tjera të prodhimit, pa pasur veshjet e posaçme të pastra të shërbimit;



c) tërheqja e blerësve me thirrje ose zhurma të ndryshme;

ç) futja e qenve;

d) ndezja e zjarreve;

dh) prishja e rregullit dhe e disiplinës së Qendrës ose e shitblerjeve;

e) prekja e mallit para dhe gjatë blerjes nga ana e personave jo të autorizuar;

ë) hyrja në sallën e ankandit e personave që nuk përfshihen në operacionet e tregut, përveç atyre të autorizuar nga drejtori i Qendrës.

2. Tregtarët dhe personeli tjetër ndihmës mund të shpallin në vendet e caktuara njoftime me karakter sindikal pas miratimit të drejtorit të Qendrës.

Neni 17

Përgjegjësitë

1. Me përjashtim të përgjegjësive të përcaktuara me ligj, OMP-ja e liqenit të Shkodrës nuk merr asnjë përgjegjësi të çfarëdolloj për dëmtime, humbje ose prishje të prodhimit ose gjërave që mund t'u ndodhnin operatorëve ose frekuentuesve të tregut.

2. Operatorët, punëtorët dhe frekuentuesit e Qendrës janë përgjegjës për dëmet që ata ose

vartësit e tyre u shkaktojnë pajisjeve, impianteve dhe lokaleve të Qendrës ose sidoqoftë entit administrues.

Neni 18

Masa disiplinore dhe administrative

1. Shkelja e parashikimeve të kësaj Rregulloreje dhe të vendimeve bëjnë që në ngarkim të personave përgjegjës të veprojnë masa disiplinore dhe administrative, që sipas rëndësisë së shkeljes ose përsëritjes ndahen, në:

a) paralajmërim (verbal ose me shkrim) ose pezullim të fajtorëve nga çdolloj aktiviteti në Qendrën e Ankandit, për një periudhë maksimale prej tri ditësh, nga ana e drejtorit të Qendrës;

b) pezullim nga çdo aktivitet i Qendrës për një kohëzgjatje maksimale prej tre muajsh të dhënë me vendim nga Komiteti Këshillimor i Qendrës, pasi ka dëgjuar edhe pretendimin e të interesuarit. Në rastet e rënda dhe urgjente ky pezullim mund të jepet edhe nga drejtori i Qendrës.

2. Masat e pezullimit, për më shumë se tri ditë të dhëna nga drejtori i Qendrës, duhet t'i komunikohen menjëherë Komitetit Këshillimor të Qendrës dhe humbasin vlefshmërinë e tyre, në rast se nuk miratohen brenda tri ditëve nga ky komitet.

SHTOJCA I

QENDRA E ANKANDIT SHIROKË

FLETA E ANKANDIT

Të dhënat e prodhimit		Të dhënat e shitjes	
		Data	
		Vendi	
Data e zbarkimit		Shitësi (emri)	
		Blerësi (emri)	
Zona e zënies së peshkut		NIPT-i (i blerësit)	
		Nr. i lejes së peshkimit/kodi i prodhuesit	

Emri	Pesha kg	Çmimi/kg	Çmimi total	Nr. i arkave	Kat. i freskisë



URDHËR

Nr. 459, datë 12.10.2022

**PËR SHPALLJEN E ZONËS SË
SHËNUAR DHE MASAT PËR
KUFIZIMIN E PËRHAPJES SË
DËMTUESIT PËR VIRUSIN E
RRUDHOSJES KAFE TË FRUTËS SË
DOMATES (ToBRFV)”**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, dhe mbështetur në pikën 2, të nenit 16, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e zonës së shënuar për dëmtuesin karantinor të virusit të rrudhosjes kafe të frutës së domates (ToBRFV), si më poshtë vijon:

Zonë e infektuar: Sipërfaqja prej 0.4 ha e mbjellë me spec në zonën kadastrale nr. 2834, me numër pasurie 98/14, e cila kufizohet me V 98/13, L 98/27, J 98/15, P 166 dhe ndodhet në fshatin Orman-Pojan, Bashkia Maliq.

Zonë sigurie: Zona 30 metra rreth zonës së infektuar.

2. Në zonën e shënuar, sipas pikës 1 të këtij urdhri, nën mbikëqyrjen e Drejtorisë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Elbasan, të zbatohen masat për çrrënjosjen e virusit ToBRFV, si më poshtë:

a) Të gjitha bimët e infektuara, bujtëse dhe pjesët bimore të shkatërrohen me djegie ose groposje të thellë.

b) Makineritë, pajisjet (përfshirë veshjet dhe mjetet mbrojtëse) nuk duhet të largohen nga vendi i prodhimit. Në të kundërt të bëhet dezinfektimi i tyre. Mjetet (gërrshërë, thika etj.) dezinfektohen në mënyrë të përsëritur.

c) Lëvizja e personelit nga zona e shënuar duhet të kufizohet. Larja dhe dezinfektimi i këpucëve, duarve etj. të kryhet menjëherë pas daljes nga zona e infektuar.

ç) Kompostoja në të cilin janë depozituar mbetjet e bimëve ose frutat e specave nuk duhet të përdoret në prodhimin e bimëve bujtëse.

d) Të zbatohen masat higjienike, kur lëvizet nga zona e infektuar.

dh) Ripërdorimi i paketimit (ambalazhet plastike, kuti etj.) të dezinfektohet përpara ripërdorimit.

e) Të bëhet qarkullimi bujqësor me bimë jobujtëse, të paktën për një periudhë kohore prej një viti.

ë) Gjatë periudhës njëvjeçare duhet të merren masat për të parandaluar mbirjen rastësore të bimëve të specit dhe të bimëve bujtëse.

f) Të bëhet plugim i thellë i tokës, jo më pak se 45 cm.

3. Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Elbasan vë në dijeni për këtë urdhër Bashkinë Korçë dhe operatorët profesionistë.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Korçë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESMINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Dhimitër Kote

URDHËR

Nr. 621, datë 17.10.2022

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 2 të nenit 28 dhe të nenit 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të ministrisë përgjegjëse për arsimin për realizimin e procedurave të mbështetjes financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të atyre që ndjekin programet e fushave prioritare, sipas udhëzimit nr. 27, datë 2.8.2022, “Për përcaktimin e rregullave, afateve të aplikimit, shqyrtimit dhe procedurat e masës dhe mënyrës së financimit të studentëve të shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar”, tek



Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL).

2. Financimi i studentëve realizohet sipas procedurës së parashikuar në këtë udhëzim.

3. Ministria e Arsimit dhe Sportit mbikëqyr realizimin e procedurave nga Agjencia Kombëtare e Arsimit të Lartë, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

4. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen deri në shfuqizimin e këtij urdhri, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.

5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

KËRKESE

Shtetasja Rolanda Bulku kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen e vdekjes së bashkëshortit të saj, shtetasit Arjan Bulku, i datëlindjes 2.4.1970, lindur dhe banues në Tiranë.

KËRKUES
Rolanda Bulku

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë